



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Në bazë të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me numër 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, për subvencionet në fushën e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Podujevës shpallë:

FTESË PUBLIKE

**PËR APLIKIM NË PROJEKTIN:
PËRKRAHJE ME FIDANE TË MJEDRAVE**

Përfitues: 10 fermerë me nga 1100 €

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:

1. *Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;*
2. *Çertifikata e bashkësisë familjare;*
3. *Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;*
4. *Fletëposedimi (origjinal) për patundshmëri;*
5. *Çertifikata e regjistrimit të fermerit-NIF-i;*

Përparësit:

Poena

1. Aplikuesit të cilët nuk kanë përfituar në ndonjë projekt në 3 vitet e fundit 10
2. Aplikuesi është apo ka anëtar të familjes me aftësi të kufizuara, invalid i luftës/familje e dëshmorit/familje me jetim apo në kuadër të ndihmave sociale; 10
(Çertifikatë/Vërtetim, kopje e kartonit të ndihmave sociale të aplikuesit apo ndonjë anëtar i familjes, etj.)
3. Numri i antarëve të familjes (për çdo anëtar 5 poena)

Sgarim:

- Furnizimi me fidane të mjedrave do të bëhet nga vetë fermerët-përfituesit, në etnitete që janë licencuar për prodhimin apo tregtimin e varieteteve të kërkuara të mjedrës;
- Fidanet duhet të jenë të importuara nga BE;
- Fidanet duhet të jenë të gjelbërta;
- Përfituesit e fidaneve duhet të kenë burimin e ujit;
- Mbjellja e fidaneve duhet të jetë sipas kritereve agroteknike
- Pjesa tjetër e investimit të bëhet nga vetë fermerët;
- Përfituesit duhet të sjellin faturen e rregullt për blerjen e fidaneve të mjedrës;
- Pagesa do të bëhet pas konstatimit të organit përkatës komunal pasi të jenë përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara;
- Vlera maximale që do të paguhet për një fermer është 1100€.

Koha dhe vendi i mbjelljes:

- Mbjellja e mjedrës duhet të bëhet në Pranverë.
- Kultivimi i mjedrës do të bëhet në tërë teritorin e Komunës së Podujevës.

Aplikacionet (kërkesat) dorëzohen në Zyren e Shërbimit të Qytetarëve.

Afati i aplikimit është deri me datë 29.03.2024, në ora 16:00

Nr: 12-320/01-0017267/24

Podujevë, 11.03.2024



Drejtori i DBPZHR

Lirie Hoti

Mars, 2024